



Besa është mundur në shtëpi ndërsa Partizani vëc fitores ka rikthyer edhe qetesinë. Një gol i shënuar nga Aldo Mitraj në pjesën e dytë i ka dhënë të kuqve tri pike mëjft të vlefshme në objektivin për të parë në vendet e larta në tabelën e klasifikimit. Partizani ka vuajtur por duke duruar ka gjetur momentin për të shënuar golin e suksesit në Kavajë. Vendasit si një skuadër e coroditur kanë kërkuar të shënojnë por e kanë patur të pamundur të finalizojnë rastet e krijuara. Goli i Mitraj i ka dhënë qetesinë e duhur trajnerit Lika që me pas ka vendosur si duhet skuadrën në mbrojtje për të pritur fundin e ndeshjes. Të kuqet përballojnë Besën dhe në përfundim të ndeshjes festojnë me tifozet.